

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “A.F.M. COMPANY 88,91” SH.P.K.

Në Pogradec, sot në datën 23 Maj 2023, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, une ortaku themelues i poshtëshënuar:

Olsi Qato Brancolini i datëlindjes 24.06.1981 me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, banues në Tiranë, i identifikuar me nr. Personal I10624056A.

VENDOSA:

Të themeloj Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. duke hartuar këtë “Akt - Themelimi” me këto kushte:

Neni 1

Në kuptimin e këtij Akt - Themelimi, ortaku i mësipërm është themelues i Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “A.F.M. COMPANY 88,91”sh.p.k. me seli në adresën:

Pasuria nr 14/449, Lagjja 4, Përroi i Çaprazit, Pogradec.

Neni 2

Veprimtaria e Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. marrëdhëniet e saj me persona të tretë, privatë e shtetërorë, në vazhdimësinë e tyre normale, do të rregullohen në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në bazë të “Kodit Civil” të Republikës së Shqipërisë, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala nga organizmat e Shtetit Shqiptar, duke respektuar kërkesat e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k.

Neni 3

Për detyrimet e veta Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. përgjigjet me pasuritë e saj.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë, emërtimi, selia e Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. shtimi i ortakëve dhe ato çka janë përcaktuar në Statut, mund të ndryshojnë me vendimin e Asamblesë së ortakëve dhe në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. do të jetë:

Ndertime civile, industriale, ekonomike, turistike dhe bujqesore deri ne dy kate e mbi dy kate. Kompletimi dhe instalimi i veprave me karakter social kulturor dhe te kulteve te ndryshme fetare si dhe restaurime dhe rikonstruksion godinash civile e ekonomike dhe veshje fasadash. Ndertim rrugesht te kategorise se pare deri ne te peste ndertim dhe asfaltim rrugesht dhe autostrada, punime te sinjalistikes rrugore, vijejime rrugesht, objekte te ndryshme, vepra arti,

mure prites e mbajtes etj. Ndertim ujesjellesa, kanale vaditese dhe kanalizime, mirembajtje dhe zhvillim i dekorit ne mjediset urbane. Kryerje punimesh te inxhinjerise civile te te gjitha llojeve e te veprave te artit, riparime e mirembajtje te veprave ekzistuese, izolime mbi dhe nentoke nga ujrat siperfaqesore. Punime hidraulike, druri, elektrike, melamine dhe konstrukte metalike, hidroizolimi dhe ngrohje. Punime ne fushen e sherbimeve civile, pastrim mbetjesh urbane, pastrim e gjelberim, mbjellje bari dhe krijimi masiveve pyjore. Tregtim materiale elektronike, elektrike, higjeno sanitare. Tregtim dhe montim sisteme ngrohje dhe soba e kaldaja ngrohje. Montimi i materialeve duralumini, duroplast dhe mobilje. Shërbime mbikqyrje, administrimi, ndihmëse në fushën e parkimit me pagesë, terminal autobusash të mjeteve motorrike të të gjitha llojeve ose mjeteve të tjera jo motorrike. Dhënie dhe marrje me qera të ambienteve të ndryshme, dhënie me nënqera. Restorant, bar-bufe, lavazho, gomisteri, shërbim taksi, makina me qera dhe shitblerje makinash. Tregëtim mallrash, materialeve të ndryshme, tregti me shumicë dhe pakicë, artikuj të ndryshëm industrialë, ushqimorë, hidrosanitarë, elektrikë, etj. Aktivitetet në fushën e shitjes dhe tregëtimit të karburanteve të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë. Transport Mallrash për vete dhe për të tretë, brenda dhe jashte vendit. Import, Eksport. Ndertimin, blerjen, menaxhimin, prodhimin, shperndarjen dhe shitjen e energjise elektrike te prodhuar nga burimet e rinovueshme dhe konvencionale. Ndertimi i centraleve, operimi dhe transferimi i tyre ku perfshihet, financimi, projektimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi dhe shperndarja e energjise elektrike. Importi dher venia ne perdorim e turbinave, paneleve diellore dhe pajisjeve per prodhimin e energjise te te gjitha llojeve. Importi dhe venia ne perdorim e eksportimi dhe shitja e energjise elektrike ne zbatim te kontratave koncesionare. Si dhe çdo gjë që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të aktivitetit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të krijojë filiale, degë e përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me Legjislacionin e vendeve të tjera në të cilat mund të vendosi filiale me të cilat do të ushtrojë aktivitetin. Ajo mund të lidhë kontrata dhënie dhe marrje me qera me persona fizikë ose shoqëri të tjera tregtare, nëse e konsideron të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimit të aktivitetit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

Neni 7

Akti i Themelimit do të jetë efektiv nga data e hartimit të tij, publikuar dhe regjistruar ne Qendrën Kombëtare të Biznesit për themelimin e Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. e cila prej kësaj date ka fituar Statusin e Personit Juridik të Pavarur. Aktivitetin e saj kjo Shoqëri mund ta ushtrojë pasi të jetë regjistruar në zyrat e Tatim Taksave, të ketë depozituar Statutin dhe Aktin e Themelimit në organizma të ndryshëm shtetërorë bazuar në kërkesat e veçanta të tyre, dhe të jetë liçensuar nga organet kompetente për ushtrimin e veprimtarive ku liçensimi i aktivitetit është kërkesë detyruese nga ligjet specifike që rregullojnë aktivitetet.

Neni 8

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. do të jetë e pakufizuar.

Neni 9

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (Nëqind mijë) lekë i ndarë në 1 kuotë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku i Shoqërisë z. Olsi Qato Brancolini, i cili zotëron 100% të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Neni 10

Emërtimi i Shoqërisë do të shënohet në të gjitha dokumentet, duke u ndjekur menjëherë nga inicialet SH.P.K. Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. do të ketë vulën e saj me logon e saj të veçantë dhe specimente të veçanta, e cila do të përdoret në të gjitha dokumentat e hartuara gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Neni 11

Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare, dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin e qëllimit të veprimtarisë së saj, duke u bazuar në Legjislacionin në fuqi. Pas miratimit të Bilancit Vjetor dhe Raportit Financiar nga Asambleja e Ortakëve, Fitimi neto i përket Ortakëve dhe mund të përdoret lirisht prej tyre brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. mund të krijojë disa fonde: Fondin Themeltar, Fondin Rezervë dhe Fondin e Shpërblimit. Për zhvillimin e veprimtarisë së vet, shoqëria mund të përcaktojë edhe Fonde të tjera.

Neni 13

Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. mund të çelë llogari në banka të ndryshme. Ajo do të mbajë llogarinë dhe do të bëjë deklarimin e saj në Lekun Shqiptar, por mund të mbajë llogaritë edhe në Euro, Dollar, ose monedha të tjera të huaja. Në banka, Shoqëria mund të hapë llogari dhe të veprojë njëkohësisht me Lekun Shqiptar dhe me të gjitha monedhat e huaja në qarkullim. Ortakët, mund të kryejnë personalisht veprimet në llogaritë bankare, ose mund të autorizojnë persona të tjerë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 14

Veprimtaria ekonomike financiare e Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. mbyllet në datën 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci Vjetor i Shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Ortakëve brenda muajit Mars të vitit pasardhës, ndërsa vendimi për destinacionin e përdorimit të Fitimit neto duhet të merret po nga Asambleja e Ortakëve, brenda datës 31 Korrik të vitit pasardhës.

Neni 15

Për nevoja të veprimtarisë së saj, Shoqëria Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. mund:

- a- Të bëjë punësime të punonjësve duke lidhur kontrata sipas Legjislacionit në fuqi, në secilin vend ku ushtron veprimtarinë e saj.
- b- Te lidhë kontrata me Shoqëri te tjera sipas Legjislacionit në fuqi, në secilin vend ku ushtron veprimtarinë e saj.

Neni 16

Administratori i Shoqërisë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. do të jetë z. Olsi Qato Brancolini, detyrat dhe kompetencat e së cilit përcaktohen në Statut.

Neni 17

Administratori dhe personat e tjerë që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare “A.F.M. COMPANY 88,91” sh.p.k. janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, të informacionit dhe burimit të tij, njohuritë dhe përvojën e fituar apo shkëmbyer në kuadrin e veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe fshehtësinë e gjendjes financiare të saj. Ata janë të detyruar të ruajnë të fshehtë identitetin e shumave të depozituara, të “të ardhurave të Shoqërisë”, të depozitave të saj, si dhe veprimarinë e Shoqërisë nga goditjet direkte dhe indirekte të konkurrencës.

Ndaj atyre që shkelin këto rregulla, Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të marrë masa ndëshkimore.

ORTAKU THEMELUES

Olsi Qato Brancolini

